



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

Raport Vjetor mbi Zbatimin e Planit Vjetor të Punës të Ministrisë së Financave (Narrativ) – PVPMF 2018

Periudha Raportuese Janar - Dhjetor 2018

Përmbajtja:	2
1. Dogana e Kosovës (DK)	3
2. Administrata Tatimore e Kosovës (ATK).....	4
3. Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF).....	6
4. Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP)	8
5. Thesari.....	9
6. Departamenti i Buxhetit (DB).....	11
7. Departamenti i Politikave Makroekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar (DPMBNF)	13
8. Departamenti i Politikave Fiskale dhe Tregjeve Financiare (DPFTF)	15
9. Departamenti i Tatimit në Pronë (DTP).....	16
10. Departamenti Qendror Harmonizues (DQH).....	18
11. Departamenti i Auditimit të Brendshëm (DAB).....	19
12. Departamenti Qendror i Partneritetit Publiko Private (DQPPP).....	20
13. Departamenti Ligjor (DL).....	21
14. Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP)	21
15. Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të TI-së (DMSTI).....	24
16. Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme (DSHP).....	26
17. Departamenti për Ndihmën Shtetërore (DNSH).....	28
18. Divizioni për Komunikim me Publikun (DKP)	29
19. Divizioni i Prokurimit (DP)	29
20. Divizioni për Raportim Financiar (DRF).....	30
21. Divizioni për Buxhet dhe Financa (DBF).....	31

1. Dogana e Kosovës (DK)

Gjatë periudhës 01.01.2018 deri 07.12.2018, Dogana e Kosovës ka realizuar të hyra në vlerë prej 1,053,161,409.80€, që në krahasim me të hyrat për periudhën e njëjtë të vitit të kaluar që ishin 1,033,546,016.20€, janë realizuar të hyra për rreth 1.90 % më shumë.

Në kontinuitet është ushtruar monitorimi i zbatimit të duhur të klasifikimit të mallrave, rregullave të origjinës, vlerësimit të mallrave dhe si rezultat janë trajtuar 140870 deklarata të profilizuara në kanalën e kuq dhe verdhë.

Në kanalën e kuq janë përzgjedhur 67173 deklarata për kontrolle fizike të mallrave, si dhe janë inspektuar pas zhdoganimit 68291 deklarata, e ku si rezultat vetëm në IPZH janë rivlerësuar 737 deklarata.

Si rrjedhojë e procesit në nivel të DK, janë iniciuar 1987 kundërvajtje në total, si rezultat i drejtpërdrejtë i profileve të riskut dhe kontrollit në fazën e zhdoganimit, me çrast edhe është ngritur vlera doganore si dhe janë konfiskuar sasi e konsiderueshme e mallrave që shkelin të Drejtën e Pronësisë Intelektuale (DPI).

Me qëllim të implementimit të drejtë të MSA, gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar aktivitete si: përgjigje përmes e-mail në kërkesa, takime me subjekte për sqarime të nevojshme, vizita tek subjektet, janë ekzaminuar 4760 DUD në lidhje me aplikimin e drejtë të MSA si dhe është ofruar përkrahje e plotë pikave referuese brenda dhe jashtë doganës. Nga parametrat 3.5% deri 4.5%, metoda e gjashtë e vlerësimit është aplikuar diku rreth 2.92%.

Mbi sferën e administrimit të akcizës, tek sektorët relevantë është shënuar rritje e aktiviteteve, janë zhvilluar vizita të rregullta dhe aksione të ndryshme tek kompanitë që janë subjekt i akcizës së brendshme si dhe tek bizneset e lojërave të fatit ku si rezultat numri i subjekteve të vizituara (kontrolluara) nga sektori i akcizës është 83, ndërsa të hyrat nga akciza e brendshme janë 9,531,632.54 €.

Sektori i Lojërave të Fatit ka ushtruar 930 kontrolle të lokaleve dhe 30 aktivitete të përbashkëta me ATK-në, Policinë dhe Sektorin nga Zbatimi i Ligjit ku ka realizuar të hyrat prej 14,478,742.33 €.

Departamenti i Procedurave me Ndikim Ekonomik ka pasur gjithashtu aktivitetet e rregullta, komform veprimeve të raportuara, janë zhvilluar vizita të rregullta tek subjektet që gëzojnë autorizim të procedurave me ndikim ekonomik si depo doganore, përpunim i brendshëm, përpunim nën kontrollë doganor, dhe si rezultat janë realizuar 205 vizita të rregullta dhe 216 vizita për marrje të mostrave.

Për objektivin e dytë, gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar aktivitete që lidhen me përforcimin e burimeve në Sektorin e Inteligjencës, Antikontrabandes, Hetuesisë dhe Sektorin e Monitorimit dhe të Riskut.

Në sferën e menaxhimit të riskut janë aktivizuar 131 profile specifike, 314 janë modifikuar, 77 janë de-aktivizuar dhe janë azhurnuar 4165 subjekte në lista të selektivitetit. Si rezultat, gjatë kësaj periudhe kohore janë realizuar 921 patrullime në vijën e gjelbër dhe pjesë tjera të territorit në brendësi, janë realizuar 500 kontrolle me pajisje ku si rezultat janë zbuluar 30 kg narkotik e llojit Cannabis sativa dhe ne 5 raste medikamente të ndryshme të fshehura në hapësira të modifikuara për

kontrabandë. Nga Hetuesia për periudhën raportuese janë iniciuar 53 raste të reja për hetim, përdërisa janë ngritur 45 kallëzime penale.

Për periudhën raportuese janë trajtuar dhe aprovuar 16 kërkesa të reja për 70 marka tregtare, ndërsa për vazhdimin e afatit janë trajtuar 94 kërkesa për 379 marka tregtare. Në mungesë të informatave shtesë janë refuzuar 4 kërkesa për veprim doganor. Nga sferën e pajtueshmërisë së kontrollit pas zhdoganimit janë realizuar 222. Kontrollte të ushtruara në të gjitha kanalet e selektivitetit, 32 raste kanë rezultuar me të gjetura sipas procesverbaleve për kundërvajtje doganore, 24 kontrollte të ushtruara në P.K.K në kuadër të 16 Planeve operative.

Gjatë periudhës raportuese në kontinuitet janë ndërmarrë aktivitete veprime dhe takime që fuqizojnë pajtueshmërinë në sferën e bashkëpunimeve bilaterale me Administratat Doganore të BE-së dhe shteteve tjera si rrjedhojë janë shkëmbyer 119 korrespondenca me administrata tjera doganore ku 20 prej tyre ishin korrespondenca me vendet e BE. Ka pas raportime të rregullta në Komision Evropian, Zyrën e BE-së dhe në MIE, si dhe raportimet e rregullta të kërkuara nga OBD, dhe pjesëmarrja në takime dhe konferenca të organizuara nga OBD.

Gjatë periudhës raportuese në SSP janë paraqitur 146 deklarime pasurore të zyrtarëve doganor, raste disiplinore të pranuar 9 dhe raste të hetuara 10, janë realizuar 45 inspektime në terren (PKK dhe ZBD) si dhe inspektime të sistemeve dhe janë dërguar rekomandimet për përmirësim të procedurave të punës.

2. Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)

ATK ka arritur që tatimpaguesve t'u siguroi edukim, informim dhe lehtësimi për procedurat e ofrimit të shërbimeve profesionale, transparente dhe efikase konform Legjislacionit Tatimor.

Gjatë periudhës raportuese janë finalizuar 4 koncept dokumentet për Ligjet si;

Tatimi në të Ardhurat Personale

Tatimi në të Ardhurat e Korporatave

Tatimi në Vlerën e Shtuar dhe

Ligji mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Ndërsa, sa i përket koncept dokumentit të Ligjit për Lojërat e Fatit, gjatë periudhës raportuese koncept dokumenti është hartuar dhe është përcjellë për Konsultim paraprak.

Tani është në fazën e konsultimit publik me të gjitha institucionet si dhe palët e interesit.

Gjatë vitit 2018 janë pranuar 427 kërkesa për rimbursim të TVSH-së. Lidhur me përmirësimin e mëtejshëm të sistemit elektronik për mbledhjen e të hyrave Tatimore gjatë këtij viti, numri i bizneseve/ tatimpaguesve që kanë shfrytëzuar Sistemin Elektronik EDI për të dorëzuar blerjet dhe shitjet online është 12,813. Gjithsej tatimpagues që kanë dorëzuar Librin e blerjeve janë 12,485 dhe tatimpagues që kanë dorëzuar Librin e shitjeve janë 12,364.

Gjatë periudhës raportuese, lidhur me marrëveshjet ndërkombëtare për eliminimin e tatimit të dyfishtë, është pranuar përgjigje pozitive për fillimin e negociatave me Portugalinë, Holandën, Italinë dhe Finlandën.

Shuma e të hyrave tatimore të inkasuara për periudhën Janar- Dhjetor /2018 është në shumën prej 434,324,664.42 milion€, ndërsa Kontributeve Pensionale janë në shumën prej 148,300,043.00 milion€.

Gjatë periudhës raportuese, me qëllim të Luftimit të evazionit tatimor dhe shmangies tatimore janë realizuar aktivitete operative si: 43,810 vizita dhe 1,563 kontrole. Rezultatet e këtyre aktiviteteve kishte, 121,598,343.32€ qarkullim shtesë, 3,623,028.53€ ulje të kreditimit të TVSh, 8,244,199.88€ tatim shtesë, 5969 gjoba që përfshinë vlerën prej 1,430,325€; 2,565 punëtorë të identifikuar si të regjistruar; 509,624.06€ vlera e mallit pa origjinë e identifikuar.

Gjatë vitit 2018, shuma e rimbursuar për periudhën Janar- Dhjetor 2018 për rimbursim- kthim Tatimin në Vlerën e Shtuar; Tatimin në të Ardhurat Personale; Tatimin në të Ardhurat e Korporatave dhe Kontribute Pensionale është:

- shuma e kërkuar për të gjitha llojet e tatimit është 63,464,807.24 €;
- shuma e aprovuar për të gjitha llojet e tatimit është 46,811,437.25 €
- shuma e transferuar në llogari të tatimpaguesit është 38,605,012.53 €
- shuma në obligime në ATK është 6,818,065.18 €
- shuma në KP/ trust pensional dhe kthim ne TP është 1,388,358.7 €

Lidhur me automatizimin e plotë të procesit të rimbursimit të TVSh, gjatë periudhës raportuese është realizuar asistencë teknike e përkrahur nga FMN e cila ka pasur për qëllim vlerësimin e zhvillimeve të fundit në fushën e rimbursimit të tatimeve dhe përkrahje në automatizimin e plotë të procesit të rimbursimit të TVSh. Gjithashtu, nga kuponët fiskalë të mbledhur gjatë periudhës raportuese numri i qytetarëve që kanë përfituar ishte 6,711 qytetarë, ndërsa shuma e rimbursuar ishte 6657,024.97€.

Gjatë periudhës raportuese janë fiskalizuar 2,210 biznese apo afër 18% më shumë krahasuar me vitin 2017, dhe gjithsej 3,511 PEF të instaluar.

Shuma e inkasimit të borxheve për periudhën raportuese është 71,225,060 milion euro (deri 12/12/2018). Ndërsa për periudhën e njëjtë të vitit 2017 janë inkasuar 63,674,373.16 euro, 7,550,687 euro ose 11% më shumë borxhe të inkasuara në vitin 2018.

Është zhvilluar sistemi për menaxhimin elektronik të të gjithë procesit të rimbursimit në ATK. Si proces fillon me pranimin e kërkesës elektronike nga tatimpaguesi përmes deklaratës tatimore, ku me pas çdo aktivitet i zyrtarëve përkatëse deri në gjenerimin e urdhër pagesës në Thesar, është i informatizuar plotësisht në sistemin Informativ. Gjithashtu, ky është një shërbim elektronik që është në dispozicion për tatimpaguesit, të cilët bëjnë kërkesë për Rimbursim, si: për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, Tatimin në të Ardhura Personale dhe Tatimin në të Ardhura të Korporatave. Përmes këtij shërbimi, tatimpaguesi mund të informohet se deri ku ka arritur të shqyrtohet nga ATK, kërkesa e tij për Rimbursim e dërguar më parë. Më konkretisht përmes shërbimit Menaxhimi i Rimbursimeve, tatimpaguesi mund të informohet për: Datën e kërkesës për Rimbursim, Vlerën e kërkuar, Llojin e tatimit, Statusin e shqyrtimit të kërkesës (Në pritje, Përfunduar, Refuzuar).

Kategorizimin e tatimpaguesit sipas Rregullores së brendshme të ATK-së, A, B apo C, Datën e përfundimit dhe Vlerën e aprovuar.

Në total, 12,813 tatimpagues kanë shfrytëzuar shërbimin, “Libri online i Blerjes dhe Shitjes”

Bazuar në planin e punës, është zhvilluar, testuar dhe funksionalizuar sistemi Informativ për menaxhimin e raportimit FATCA, sipas kërkesave të IRS të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ky sistem mundëson pranimin e raporteve nga Bankat Komerciale të Kosovës në formatin dhe kanalet e komunikimit sipas kërkesave teknike të Autoritetit. Gjithashtu, sistemi mundëson validimin dhe komunikimin e dyanshëm në mes Bankave Komerciale dhe Sistemit në ATK, si dhe komunikimi dy drejtimesh ATK IRS/IDES në Shtetet e Bashkuara të Armikes.

Si projekt është realizuar plotësisht në kuadër të afateve kohore si dhe kostos buxhetore.

3. Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF)

Në Planin Vjetor të Punës së Ministrisë së Financave (PVPMF) për Vitin 2018, janë përcaktuar gjashtë (6) objektiva strategjike, të cilat kanë si synim parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

Nga gjithsej 19 aktivitete që përmban ky plani i punës, gjatë vitit 2018, NJIF-K ka zbatuar gjithsej 18 aktiviteteve ose rreth 96% e planit të punës. Ndërsa 1 aktivitet, nuk ka filluar të zbatohet.

Janë pranuar gjithsej 10,592 raporte gjatë vitit 2018;

Në Maj 2018, NJIF-K ka hartuar Tipologjitë e Pastrimit të parave nga personat e ekspozuar politikisht në Kosovë, të cilat janë publikuar ne web: http://fiu.rks-gov.net/ep-content/uploads/2018/06/PEPs-Typologies_ALB-SRB-ANG.pdf.

Në kuadër të **Promovimit në parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe intensifikimi i mbikëqyrjes së pajtueshmërisë**, NJIF-K ka zhvilluar këto aktivitete

- Përqindja e arritjes në hartimin dhe implementimin e planit vjetor për mbikëqyrje të pajtueshmërisë është 77%;
- Numri i aktiviteteve mbikëqyrëse 16;
- Është kryer Vlerësimi i rrezikut specifik sektorial për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin të terrorizmit mbi kazinotë dhe lojërat e fatit, ndërtimtarisë dhe patundshmërive dhe vlerësimi i Rrezikut në Sektorin e OJF-ve.

Të tri vlerësimet e rreziqeve sektoriale janë finalizuar në K2, janë aprovuar nga Bordi i NJIF-K, dhe me Vendimin e Qeverisë nr.10 dhe 11/52, janë miratuar;

Gjithsej 38 raporte janë trajtuar në lidhje me rastet e dyshuara të ekstremizmit dhe radikalizmit;

Sa i përket **Zhvillimit, standardizimit dhe intensifikimit të proceseve të raportimit, inteligjencës dhe analizave dhe promovimi i bashkëpunimit të agjencioneve për zbulimin dhe hetimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si dhe konfiskimit të të ardhurave nga krimi**, NJIF-K ka zhvilluar këto aktivitete gjatë vitit,2018:

NjIF-K, gjithashtu ka zhvilluar edhe këto aktivitete:

- Vlerësimi periodik i Transaksioneve të gatshme (kesh) të raportuara nga subjektet;
- Rreth 6501 raporte janë pranuar dhe kontrolluar nga IT gjate vitit 2018;
- Gjithsej 539 raporte janë kthyer mbrapa ne lidhje me përmirësimin e cilësisë së raportimit;
- Gjithsej 6501 raporte janë pranuar gjate vitit 2018;
- Numri i raporteve të transaksioneve të dyshimta për PP (RTD), të pranuar është 590;
- Numri i raporteve të transaksioneve të dyshimta për FT (TFR) të pranuar është 9;
- Numri i raporteve për transaksionet e parave të gatshme (keshit) (RTG) të pranuar është 2,247;
- Numri i raporteve të inteligjencës të shpërndara tek autoritetet e mandatuara është 105;
- Numri i kërkesave për informata të pranuar prej autoriteteve kombëtare (IRD), është 147;
- Numri i kërkesave për informata të shpërndara tek autoritetet vendore (ORD), është 2,326;
- Numri i udhëzimeve të lëshuara dhe transaksioneve të pezulluara është 4;
- Vlera e transaksioneve të pezulluara/ngrira është 250.000,00 €;

ATK ka përcjell 16 informata kthyesë tek NJIF-K. Ndërsa, Koordinatori Kombëtar ka përcjell një vendim të Gjykatës për dënim për PP;

NJIF ka analizuar 38 raporte për individë apo grupe ekstremiste që paraqesin rrezik potencial.

Sa i përket zhvillimit të legjislacionit për PPP/LFT dhe standardeve të brendshme të NjIF-K dhe sigurimi i implementimit të tyre efikas, NJIF-K ka zhvilluar këto aktivitete:

- NJIF-K ka miratuar 5 akte nënligjore
- Në dhjetor NJIF-K ka hartuar planin e akteve nënligjore për miratim në vitin 2019;
- Përqindja e arritjes në implementimin e planit të veprimit për implementim të dispozitave ligjore të ligjit 05/L-096 është 56 %;

NJIF-K ka miratuar aktet nënligjore si në vijim:

- Udhëzuesin FIUAD: 40/2018
- Udhëzuesin FIUAD: 70/2018
- Rregulloren për organizimin e brendshme të NJIF-K
- Udhëzimi administrativ për mbajtjen e statistikave për PPP/LFT Nr.01/2018, dhe
- Udhëzimi administrativ për Personat e Ekspozuar Politikisht PEP- MF (NJIF), Nr. 02/2018.

Në kuadër të **Bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin e pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit**, NJIF-K ka zhvilluar këto aktivitete:

NJIF-K ka marrë pjesë në takimin Plenar të Egmont Grup dhe takimin e ndërmjetëm. Takimet janë mbajtur në Mars dhe Shtator 2018;

-Janë mbajtur takime me mbi 30 njësi homologe ndërkombëtare, Për më tepër NJIF-K ka marrë pjesë në trajnimet e Egmont Group;

-NJIF-K nuk është ftuar të marrë pjesë në takimin e FIU-ve rajonale të mbajtur në tetor 2018 në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë. Kjo duket të jetë për arsye politike;

-NJIF-K ka nënshkruar MoU me Senegalin dhe Jordaninë;

-NJIF-K ka mbajtur takime me njësitë homologe në Australi, Argjentinë, South Korea.

- Ndërsa në Nëntor ka marrë pjesë në takimin e vendeve të Ballkanit dhe Baltikut të mbajtur në Tiranë, Shqipëri;
- Numri i kërkesave të pranuar për shkëmbim të informatave (IRI),28;
- Numri i kërkesave të dërguara për shkëmbim ndërkombëtar të informatave (ORI është 60);
- Numri i raporteve spontane të dërguara në NJIF tjerë ndërkombëtar është 10;
- Numri i raporteve spontane të pranuar nga NJIF tjerë ndërkombëtar është 12.

Gjatë periudhës raportuese, NJIF-K ka rekrutuar dy zyrtar;

Zyrtarët e NJIF-K kanë marrë pjesë në 45 trajnime, kurse në trajnime të specializuara vendore dhe ndërkombëtare, numri i trajnimeve, konferenca, seminare për fushën e kundër ekstremizmit, radikalizmit dhe terrorizmit ka qenë 5;

Është kryer me sukses upgraid i softverit GoAML, dhe në mënyrë të vazhdueshme janë ndërruar serverët e vjetër me të ri;

Është bërë vlerësimi i nevojës për qasje në bazën e të dhënave të institucioneve në AKK;

Mundësimi i qasjeve në bazën e të dhënave të institucioneve tjera. NJIF ka qasje në Polici, Doganë, ARBK, Regjistrim të automjeteve, ATK, Regjistrin e OJQ-ve dhe së fundi edhe tek Agjencioni i Regjistrimit Civil.

4. Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP)

Gjatë periudhës raportuese, AQP konsideron se kursimi i arritur në kontratat e realizuara është rreth 8% .

AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT					
Aktivitetet e Prokurimit deri më 10.10.2018					
Prokurimet e Centralizuara					
	Titulli i Kontratës	Data e Nënshkrimit të Kontratës,	Të Kontraktuara	Lloji I Kontratës	Gjendja
1	Shërbime të fotokopjimit, Lot. 1	27.02.2018	3,726,000.00	Kontratë me qira	e kontraktuar
2	Shërbime të fotokopjimit, Lot. 2	27.02.2018	1,827,000.00	Kontratë me qira	e kontraktuar
3	Furnizim me derivate të lëngëta, lot. 6	01.03.2018	2,551,872.73	Kontrate kornizë	e kontraktuar
4	Furnizimi me materiale të ndryshme zyrtare, lot. I	23.04.2018	83,816.96	Kontratë kornizë	e kontraktuar
5	Furnizimi me materiale të ndryshme zyrtare, lot. II	23.04.2018	18,892.30	Kontratë kornizë	e kontraktuar
6	Furnizimi me materiale të ndryshme zyrtare, lot. III	23.04.2018	16,298.10	Kontratë kornizë	e kontraktuar
7	Furnizimi me materiale të ndryshme zyrtare, lot. IV	24.04.2018	20,817.00	Kontratë kornizë	e kontraktuar

8	Furnizimi me materiale të ndryshme zyrtare, lot.VI	23.04.2018	16,552.35	Kontratë kornizë	e kontraktuar
9	Furnizimi me materiale të ndryshme zyrtare, lot. VII	23.04.2018	16,683.90	Kontratë kornizë	e kontraktuar
10	Shfrytëzimi afatgj. I automj. me qira, kat 3,lot 2	27.03.2018	1,281,749.04	Kontratë me qira	e kontraktuar
11	shërbime të pastrimit	25.05.2018	533,000.00	Kontratë kornizë	e kontraktuar
12	Shfrytëzimi afatgj i automjeteve me qira, kat 2,lot 1 dhe 2, aneks	01.06.2018	458,040.00	Kontratë me qira	e kontraktuar
13	Furnizimi me materiale të ndryshme zyrtare, lot. V	01.06.2018	11,043.98	Kontratë kornizë	e kontraktuar
14	Furnizimi me karburante, lot V	05.07.2018	2,033,213.22	Kontratë kornizë	e kontraktuar
14	Furnizimi me TI		9,000,000.00		në vlerësim
15	Furnizimi me vetura te udhëtarëve, lot 1	04.10.2018	593,670.00	Kontratë kornizë	e kontraktuar
16	Furnizimi me vetura të udhëtarëve, lot 2	05.10.2018	348,771.67	Kontratë kornizë	e kontraktuar
17	Shërbime të transportit-aviobleta	23.11.2018	5,037,500.00	Kontratë kornizë	e kontraktuar
18	Vetura, Kategoria I, lot 1 dhe 2, Aneks kontratë	10.10.2018	244,530.00	Kontratë me qira	e kontraktuar
19	Furnizimi me mazut	23.11.2018	3,196,085.20	Kontratë kornizë	e kontraktuar
20	Furnizim me automjete të udhëtarëve, lot 1.	27.11.2018	357,600.00	Kontratë kornizë	e kontraktuar
21	Shërbime të fotokpjimit për nivelin lokal		2,000,000.00		në vlerësim
22	Furnizimi me derivate të naftës		35,000,000.00		në vlerësim
23	Furnizim me automjete të udhëtarëve, lot 2.				në procedurë
			Të kontraktuara 23,000,000.00		Në procedurë 46,000,000.00

5. Thesari

Sa i përket draftit të **planit kontabël sipas GFSM 2014** duhet theksuar se është në proces e sipër. Është përgatit manuali për komentimin e kodeve ekonomike të planit ekzistues si dhe është finalizuar tabela ndërlidhëse në mes planit kontabël aktual dhe klasifikimit në statistikat financiare qeveritare të publikuara në vitin 2014 (GFSM 2014),

Vlenë të theksohet që është në proces përgatitja e **Kalendarit të Letrave me Vlerë për vitin 2019**. Është hartuar drafti fillestar me dokumentet përcjellëse dhe pritet finalizimi dhe dërgimi për Aprovim tek Ministri.

Gjithashtu, Koncept Dokumenti për Borxhin Shtetëror është finalizuar dhe bashkë me dokumentet e tjera përcjellëse është dërguar në Qeveri për miratim.

Drafti i Ligjit të ri pritet të finalizohet brenda këtij viti dhe të prezantohet para Ekspertit Punues për diskutim dhe finalizimin e draft Ligjit.

Rishikimi i tri rregulloreve do të vazhdojë krahas procesit të aprovimit të Ligjit për Borxhin Shtetëror ndërsa si proces do të mund të finalizohet pas aprovimit të Ligjit.

Në kuadër të **Ngritjes dhe zhvillimit të Sistemit për Menaxhimin e Financave Publike (SIMFK)**, është nënshkruar kontrata për zhvillimin e modulit për procedimin e pagesave online-RTGS, dhe kemi mbërritur në fazën e testimit të pagesave, ndërsa pritet deri në fund të vitit të implementohet komplet projekti dhe me 1 janar 2019 të kalohet live.

Është bërë konfigurimi i sistemit për bashkëngjitje të dokumenteve në SIMFK-së të moduli i urdhër blerjeve, pjesa bazë e kontratës dhe moduli i shpenzimeve me fatura.

Sa i përket **Ngritjes së kapaciteteve harduerike dhe Softuerike, dhe e sigurisë së TI-së për Thesar**, janë vlerësuar ofertat është shpallur kompania fituese, është nënshkruar kontrata dhe jemi në pritje të liferimit të pajisjeve.

Pas refuzimit të kërkesës për vendosjen e pajisjeve në BQK dhe ATK në Prizren, së bashku me menaxhmentin është vendosur që pajisjet të vendosen përkohësisht në ASHI.

Lidhur me **Ngritjen (Upgrade) e sistemit të pagave- Payroll si dhe avancimi i proceseve**, është nënshkruar kontrata për vazhdimin e mirëmbajtjes së Sistemit të Pagave.

TI ka përgatitur serverin në bazë të kërkesave të Administratorit të pagave dhe kompanisë implementuese.

Planifikohet që procesi i versionit të ri (upgrate) të përfundojë deri në fund të vitit dhe të kalohet live me 1 janar 2019.

Hartimi i Procedurës /Rregullores për sistemin e pagave është Aktivitet i bartur për vitin 2019.

Me qëllim të **Zhvillimit në sistemin për menaxhimin e Parasë së gatshme**, Thesari është në negociim me kompaninë Free Balance për mundësinë e zhvillimit të modulit shtesë për planifikimin e cash-it.

Lidhur me **Ngritjen (Upgrade) e sistemit të menaxhimit të borxheve shtetërore - CS-DRMS, në versionin e ri 2.0**, Thesari raporton se është njoftuar nga menaxhmenti që Commonwealth është duke zhvilluar platformën e re të këtij sistemi ndërsa është rekomanduar të kalohet direkt në këtë platformë e cila do të jetë e gatshme në fillim të vitit 2019.

Njëkohësisht jemi informuar nga Commonwealth që janë duke finalizuar kontratën me një kompani e cila do të angazhohet për përkrahje teknike të sistemit CS DRSMS.

6. Departamenti i Buxhetit (DB)

1. Hartimi i Projektligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2019 dhe vlerësimet për vitet 2020 -2021

Në kuadër të Hartimit të Dokumentit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021, janë zhvilluar aktivitetet si në vijim.

- Është punuar në hartimin e instruksionit të KASH-it si dokument paraprijës i procesit së hartimit të Buxhetit për vitin 2019-2021. Janë zhvilluar aktivitetet për të mbajtur takime të brendshme të Ministrisë së Financave dhe takime me anëtarët e Komisionit të Granteve.
- Me datë 09 janar 2018, është bërë përzgjedhja me short e anëtarëve të rinj të Komisionit të Granteve për katër kryetarë të komunave siç vijon: Fushë Kosovë, Drenas, Mitrovicë dhe Leposaviq për vitin 2018.
- Qeveria e Kosovës me Vendim Nr.08/36 datë 16.03.2018 ka aprovuar Raportin mbi Vlerësimin e Përshtatshmërisë së Sistemit të Financimit Komunal për vitin 2017.0
- Me datë 23 shkurt 2018 janë dërguar shkresat tek ministrinë e linjës MAPL, MPMS dhe në MSH, MASHT, lidhur me propozim Grantet specifike për arsim dhe shëndetësi dhe financimet tjera komunale, për aprovim nga Komisioni i Granteve për të finalizuar KASH-in 2019-2021 sipas LMFPF dhe LFPL.
- Komisioni i Granteve në takimin e mbajtur me datë 12 prill 2018 ka aprovuar grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2019 në kontekst të finalizimit të KASH 2019-2021 përfshirë kriteret dhe ndarjen e granteve sipas LFPL.
- Janë bërë vlerësimet e hershme sipas organizatave buxhetore për aktivitete dhe politika të reja për përfshirje në KASH-in 2019-2021 dhe me datë 27.04.2018 është aprovuar në Qeveri Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2019-2021.
- Me datë 12- 13 Korrik 2018 janë mbajtur takime konsultative me Drejtorw për Buxhet dhe Financa si dhe Zyrtarw Kryesor Financiar të Komunave, lidhur me strukturën e shpenzimeve për vitin 2019-2021 për Buxhetin Komunal.

2. Realizimi i Buxhetit gjatë vitit 2018

- Pas aprovimit të Ligjit nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, Departamenti i Buxhetit ka regjistruar në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës (SIMFK) buxhetin e aprovuar për vitin 2018 për ekzekutim.
- Nxjerrja e Instruksionit nr. Nr. 64, datë 11.01.2018 “Zbatimi i nenit 9 për Ligjin Nr.06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018. Në bazë të Instruksionit të lëshuar për të gjitha Organizatat buxhetore, janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e pranura nga organizatat buxhetore dhe janë përfshirë ndryshimet në tabelat e buxhetit për përmbushjen e obligimeve të pakryera financiare të projekteve kapitale shumëvjeçare ndaj kontraktuesve ekonomik nga viti 2017 në vitin 2018.
- Këto ndryshime në projekte kapitale janë aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin nr. 06/29, me datë 13.02.2018, dhe janë proceduar tabelat me ndryshime në Kuvendin e Republikës së Kosovës për informim.

- Janë ekzekutuar në SIMFK ndryshimet e projekteve kapitale për zbatimin e nenit 9 të Ligjit Nr.06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 pas aprovimit nga Qeveria e Kosovës.
- Pas aprovimit të Buxhetit për vitin 2018 është bërë importi i buxhetit për Komunën e Suharekës, Lipjanit dhe Kamenicës në sistemin e Free Balancit.
- Nga Shpenzimet e Paparashikuara janë ekzekutuar gjithsej: 45 Vendime të Qeverisë dhe 6 Vendime të Ministrit.
- Pas arsyeshmërisë së kërkesave janë ekzekutuar në SIMFK, 172 kërkesa për transfer dhe 89 kërkesa për rialokime të mjeteve të organizatave buxhetore.
- Është bërë bartja e të hyrave vetanake prej vitit 2017 në vitin 2018 për nivelin qendror në sistemin e Free Balance në shumë prej 2,771,889.37 euro.
- Janë ekzekutuar në SIMFK 38 kërkesa të komunave për bartje të mjeteve nga të Hyrat Vetanake të Pashpenzuara nga viti 2017 në vitin 2018.
- Janë ekzekutuar në SIMFK kërkesa të komunave lidhur me rritje të buxhetit për vitin 2018.

3. Vlerësimi i Ndikimit Buxhetor për Projektligje dhe akte tjera nënligjore si dhe dokumente strategjike

Në bazë të Planit të punës së Qeverisë dhe Ligjit të Buxhetit vjetor, të gjitha kërkesat e pranuar nga institucionet propozuese të legjislacionit të ri apo plotësim ndryshim të atij aktual si dhe strategjive për dhënie të opinionit të pavarur të Vlerësimit të Ndikimit Buxhetor gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018 Departamenti i Buxhetit i ka përgatitur dhe dorëzuar propozuesve gjithsej 162 opinione të pavarura dhe atë si vijon për: 85 - Projekt ligje; 10-Strategji; 24- Projekt Rregullore, 33-Koncept Dokumente dhe 10- Udhëzime Administrative.

4. Publikimi i dokumenteve

Në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018 janë publikuar dokumentet si vijon: Ligji me Nr 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, Informatori për Qytetarët për Buxhetin e vitit 2018, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2019-2021 Qarkorja Buxhetore 2019/01, Qarkorja Buxhetore 2019/02 për komuna, Qarkorja Buxhetore 2019/02 për organizatat buxhetore e nivelit qendror.

5. Aktivitetet tjera

- Përgatitja e sistemit të PIP- it dhe ekzekutimi i procedurës së fund vitit në administrim të sistemit të PIP që nënkupton mbylljen e sistemit për Ekzekutim 2017 Planifikim 2018 dhe hapja e sistemit për Ekzekutim 2018 Planifikim 2019.
- Barazimet në buxhetin e vitit 2017 për të gjitha kategoritë e shpenzimeve për nën kategoritë ekonomike (sipas kodit pesë shifror) me tabelat e përcjella gjatë vitit fiskal me Free Balance.
- Janë zhvilluar takime me përfaqësuesit e FMN lidhur me planifikimin, ekzekutimin (ndryshimet në buxhet) për 5 vitet e fundit dhe diskutimet për draftin e UA për transfere dhe rialokime.
- Përgatitja e raportit përmbledhës të monitorimit të progresit fizik dhe financiar të projekteve kapitale për periudhën janar- mars 2018 për projektet me vlerë mbi 1,000,000 euro, në total të ndarë për vite, për të gjitha organizatat buxhetore mbi bazë të raportimit nga OB-të në sistemin e PIP-it për projekte kapitale individuale.

- Është mbajtur trajnim për nivelin komunal mbi planifikimin e buxhetit në sistemet elektronike BDMS dhe PIP, me date 28, 31 Maj, ky trajnim është mbështetur nga USAID me të gjitha kushtet e nevojshme për trajnim. Pjesëmarrësit në trajnim ishin gjithsej 162 zyrtarë komunal, ku 91 prej tyre për sistemin e BDMS, dhe 71 zyrtarë për sistemin e Pip-it.
- Konsultime me të gjitha organizatat buxhetore dhe dhënia e rekomandimeve lidhur me planifikimin e buxhetit në sistemin e BDMS-it sipas qarkores së parë buxhetore 2019-2021.
- Konsultime me të gjitha organizatat buxhetore dhe dhënia e rekomandimeve lidhur me planifikimin e projekteve kapitale në sistemin e PIP-it sipas qarkores së parë buxhetore 2019-2021.
- Mbajtja e trajnimeve për sistemin e BDMS dhe PIP-it për modulën e planifikimit dhe monitorimit për të gjithë zyrtarët e ri të organizatave buxhetore të nivelit qendror .
- Grumbullimi dhe Sistematizimi i të dhënave lidhur me performancën e buxhetit.
- Përgatitja e raportit përmbledhës të monitorimit të progresit fizik dhe financiar të projekteve kapitale për periudhën janar-qershor 2018 për projektet me vlerë mbi >= 1,000,000 euro, në total të ndarë për vite, sipas Ligjit nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, neni 17 pika 3.
- Analiza mujore e pagave dhe kategorive tjera të shpenzimeve për të gjitha organizatat buxhetore.
- Përgatitja e financimit për Kryeqytetin në përputhje me Ligjin e Kryeqytetit.
- Përgatitja e financimit për komunën e Obiliqi në përputhje me Ligjin e Obiliqit.
- Nga data 17.07.2018 deri me 20.08.2018 është mbajtur punëtorja lidhur me draftimin e koncept dokumentit për Ligjin e Financave të Pushtetit Lokal (LFPL).
- Është përgatitur vlerësimi i ndikimit buxhetor për koncept dokumentin e LFPL.
- Konsultime me të gjitha organizatat buxhetore dhe dhënia e rekomandimeve lidhur me raportimin për projekte kapitale përmes sistemit të PIP-it monitorimit të projekteve.
- Me datë 23 Gusht 2018 është mbajtur takim me komunat veriore lidhur me procesin buxhetor 2019, sfidat dhe progresin i deritanishëm.
- Përgatitje e planit të veprimit lidhur me obligimet që derivojnë për Departamentin e buxhetit nga plani i zbatimit të rekomandimeve për RVA.

7. Departamenti i Politikave Makroekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar (DPMBNF)

Divizioni i Makroekonomisë

Gjatë muajit Janar u përfundua hartimi i Programit Kombëtar për Reforma në Ekonomi dhe dokumenti final u dërgua në Qeveri për aprovim. I njëjti me datën 31 janar u dërgua (brenda afatit kohor) tek Komisioni Evropian. Takimet vlerësuese të komisionit evropian për PKRE-në e dorëzuar në Janar u mbajtën me delegacionet nga Banka Qendrore Evropiane dhe Komisioni Evropian (ECFIN) ku edhe u pranuan komente pozitive lidhur me këtë dokument.

Gjatë muajit prill u finalizua dhe u dërgua për miratim në qeveri KASH-i 2019-2021, pjesë integrale e së cilës është edhe korniza makro fiskale. Përveç për hartimin e Kornizës, Njësia e

Makroekonomisë ishte përgjegjëse edhe për koordinimin e aktiviteteve mes Buxhetit, Zyrës për Planifikim Strategjik (ku është përfshirë në hartimin e Deklaratës së Prioriteteve) dhe akterëve tjerë.

Gjatë muajit qershor është bërë lansimi i Programit për Reforma në Ekonomi për vitin 2019.

Gjatë muajit tetor është përgatitur korniza makro-fiskale si pjesë e ligjit të buxhetit 2019.

Gjatë muajit Nëntor është bërë dorëzimi i draftit të PRE 2019 i cili do të publikohet për konsultime publike.

Sa i përket muajve tjerë, janë publikuar pasqyra makroekonomike për periudhën TM1, TM2 dhe TM3 2018. Kjo pasqyrë paraqet një përmbledhje koncize të zhvillimeve për treguesit kryesor në ekonominë e Kosovës përgjatë periudhës së dhënë.

Gjatë këtij viti, është përcjellë në vazhdimësi raporti i të hyrave dhe shpenzimeve të Qeverisë, si dhe janë hartuar raportet mbi performancën e të hyrave dhe shpenzimeve për secilin muaj, të cilët u dërguan në kabinet për informim. Gjithashtu, rregullisht është bërë përditësimi i modelit të parashikimeve makroekonomike me të dhënat e publikuara nga BQK dhe ASK, si dhe nga institucionet ndërkombëtare.

Janë mbajtur një numër takimesh me përfaqësues të ndryshëm të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore për të diskutuar parashikimet makro fiskale në KASH, PKRE, buxhet etj.

Gjatë kësaj periudhe është bërë përditësimi i raporteve të rregullta si: PKZMSA-së, DPSA, PVPQ, PVPMF, SRMFP etj. Përfaqësuesit e njësisë së makroekonomisë morën pjesë në grupet punuese ministrore dhe ndër-ministrore sipas kërkesës.

Divizioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar:

Janë nënshkruar marrëveshje financiare të grantit në vlerë prej 160.776 milionë euro, për 13 projekte të ndryshme, me Bashkimin Evropian, KfW, Qeverinë Gjermane, Qeverinë e Luksemburgut, BERZH-in, si dhe Bankën Botërore.

Projektet përfshijnë:

- Grant i BE-së për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore 10, Segmenti 1- Hani i Elezit – Fushë Kosovë
- Marrëveshja për Programin e Sektorit të Energjisë, Faza VIII dhe IX- Përmirësimi i Ngrohtores së Qytetit në Prishtinë
- Marrëveshja për Shërbime Profesionale të Pranuesit në kuadrin e Programit II të Menaxhimit të Mbeturinave
- Projekti për vazhdimin e përmirësimit të sistemit të tatimit në pronë “Pro Tax 2”
- Programi i menaxhimit të mbeturinave të ngurta në Kosovë- investime në 4 deponi nën pronësi të shtetit
- Mënjanimi i ujërave të zeza në Kosovën Jugperëndimore- Faza V për Komunën e Pejës, Gjakovës, dhe Prizrenit
- Zgjerimi i Rrjetit të Termokosit në Prishtinë
- Zgjerimi i rrjetit të ujit të pijes dhe kanalizimit në zonat rurale- Faza 6 (dalëse) e projektit
- Zhvillimi i procedurave të brendshme për aprovim- Projekti i Rrugëve Rajonale
- Mbështetje të Fondit për Garantimin e Kredive- krijimi i vendeve të punës në sektorin e bujqësisë

- Protokoll i Bashkëpunimit Teknik dhe Financiar me Qeverinë Gjermane 2018-2019
- Grante nga Banka Botërore për projekte të ndryshme
- Grant i BE-së për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore 10, Segmenti 2 Fushë Kosovë – Mitrovicë

Ndërsa, janë përmbyllur edhe 8 marrëveshje kredie, në sektorin e infrastrukturës rrugore, ujore, trajtim të ujërave të zeza, dhe qasje në internet, në vlerë prej 123 milionë euro, me kreditorë si Qeveria Austriake, BERZH, si dhe Banka Botërore:

- Ndërtimi i segmentit të rrugës Kijevë Zahaq të Autostradës Prishtinë-Pejë
- Marrëveshja për projektin për trajtimin e ujërave të zeza në Komunën e Podujevës
- Ndërtimi i Skemës për Furnizim me Ujë në Komunën e Ferizajt
- Ndërtimi i Skemës për Furnizim me Ujë në Komunën e Graçanicës
- Ndërtimin e Skemës për Furnizim me Ujë në Komunën e Istogut
- Trajtimi i Ujërave të Zeza në Komunën e Shtimes
- Ekonomia Digjitale në Kosovë- zgjerimi i rrjetit të internetit nëpër zona rurale

Të gjitha marrëveshjet financiare të nënshkruara janë për projekte të listës prioritare të projekteve, të miratuara nga Këshilli Kombëtar për Investime. Lista është azhurnuar në gjysmën e dytë të vitit 2018, për të shtuar projekte të cilat janë reflektuar edhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe buxhet.

Në muajin prill 2018 është përgatitur Raporti për Implementimin e Klauzolës për Investime, i cili është aprovuar nga Qeveria e Kosovës dhe i është dërguar Kuvendit të Kosovës për njoftim. Gjithashtu, gjatë përgatitjes së Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, Tabelave të Buxhetit 2019, si dhe Raportit për Reforma në Ekonomi për vitin 2019, tabelat e Klauzolës për Investime janë rifreskuar duke përfshirë disa projekte të reja me rëndësi, kryesisht në sektorin e mjedisit, infrastrukturës, etj.

Janë nënshkruar dhe ratifikuar 2 METD me Austrinë dhe Dukatin e Madh të Luksemburgut. Dy marrëveshjet presin ratifikim nga shtetet përkatëse për të hyrë në fuqi. Janë iniciuar negociatat për METD me shtetet në vijim: Katari, Kuvajti, Italia, Portugalia, Holanda, Suedia, dhe Sllovenia. Ndërsa, janë përmbyllur negociatat për METD me Belgjikën, Lituanië, Maltën, dhe Latvinië.

8. Departamenti i Politikave Fiskale dhe Tregjeve Financiare (DPFTF)

Gjatë periudhës raportuese nga Departamenti i Politikave Fiskale dhe Tregjeve Financiare, janë arritur si më poshtë.

- Përditësimi i të hyrave në Nivel Qendror dhe Lokal për periudhën Janar–Dhjetor 2018 mbi Tatimin në Pronë, Tantiemat, Të hyrat Jo Tatimore Komunale.
- Përditësimi i të hyrave nga ATK dhe Dogana për muajin Janar- Dhjetor 2018.
- Raport për monitorimin e konkluzioneve të nën komiteteve të MSA për vitin 2017-2018-2019.
- Analizë e ndikimit buxhetor sipas vendimeve 13/07 dhe 14/07 .

- Analizë mbi Ndikimin fiskal nga vendimet e Qeverisë për lirimet doganore, akcizës dhe TVSh për subjektet prodhuese për Janar- Qershor 2018
- Përgatitja e Inputeve për Raportin e KE-së për Kosovën për vitin 2018.
- Përgatitja e të hyrave nga akciza në lojërat e fatit, Janar-Dhjetor 2018.
- Pjesëmarrje në takimet për koordinimin e Agjendës Rajonale të Reformave për Investime, përkatësisht planin kombëtar
- Analizë për lirimet në import si dhe pjesëmarrja e doganës-akcizës dhe TVSH-në gjithsej importet.
- Analizë e ndikimeve fiskale 2015-2018.
- Analizë e ndikimit të Akcizës në Cigare dhe Akcizës në Vajra për ngrohje.
- Lirimet në importe për prodhues- importues sipas ATK 2015-2018.
- Numri i bizneseve të reja të regjistruara në TVSH dhe Numri i bizneseve të reja të regjistruara në TVSH 2011-2018.

9. Departamenti i Tatimit në Pronë (DTP)

Është përgatitur baza e të dhënave për faturimin 2018. Janë vendosur në sistem vlerat e pronave, normat tatimore dhe zonat tatimore të cilat janë aprovuar nga Kuvendet Komunale, bazuar në rregulloret e tyre të aprovuara gjatë vitit 2017 për vitin tatimor 2018.

Është bërë llogaritja e përgjithshme e faturave për të gjitha komunat për vitin tatimor 2018. Në total janë prodhuar 647 mijë fatura që kapin shumën e tatimit të vlerësuar prej 26,840,362.09 €.

Në zbatim të nenit 21 të ligjit Nr. 03/I-139, Datë 26.03.2009 “Për shpronësimin e pronës së paluajtshme” te ndryshuar ne kuadër të Nivelit Qendror janë pranuar dhe shqyrtuar 38 (tridhjetë e tetë), projekte përkatësisht kërkesa për vlerësim.

Në zbatim të nenit 21 të ligjit Nr. 03/I-139, Datë 26.03.2009 “Për shpronësimin e pronës së paluajtshme” te ndryshuar ne kuadër të Nivelit Komunal janë pranuar dhe shqyrtuar 46 (dyzet e gjashtë), projekte përkatësisht kërkesa për vlerësim.

Në zbatim të Ligjit Nr. 04/L-144 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës", sipas kërkesave të iniciuara për vlerësimin e pronës për këmbim janë pranuar dhe shqyrtuar 25 (Njëzet e pesë) projekte përkatësisht kërkesa.

Në kuadër të Nivelit Qendror janë hartuar dhe finalizuar aktet e vlerësimit për 33 (tridhjetë e tre), projekte përkatësisht kërkesa për vlerësim.

Në kuadër të Nivelit Komunal ka hartuar dhe finalizuar aktet e vlerësimit për 44 (dyzet e katër), projekte përkatësisht kërkesa për vlerësim.

Në kuadër të vlerësimit të pronave sipas kërkesave të iniciuara për këmbim të pronës komunale me persona fizik dhe juridik, janë hartuar dhe finalizuar aktet e vlerësimit për 18 (tetëmbëdhjetë) projekte përkatësisht kërkesa.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të zyrtarëve komunal janë mbajtur trajnime lidhur me:

1. Përdorimin e aplikacionit online për regjistrimin e pronave të paluajtshme (objekteve) dhe tatimpaguesve, si rrjedhojë e automatizimit të sistemit të tatimit në pronë. Numri i të trajnuarve ka qenë 109 zyrtarë anketues për të gjitha komunat
2. Trajnimi për përmirësimin e koordinatave të objekteve të regjistruara gabimisht nëpër komuna. Në trajnim janë përfshirë 25 komuna, numri i zyrtarëve pjesëmarrës në trajnim ka qenë 60.
3. Është mbajtur trajnimi tre ditor lidhur me planifikimin a rivlerësimin të objekteve bujqësore si dhe rreth kalibrimit të nivelit të vlerave për tokë për vlerësimin përfundimtar të tokave. Trajnimi është mbajtur nga ekspert suedez, ku janë përfshirë Divizioni i vlerësimit në mase, vlerësuesit privat të angazhuar në kuadër të projektit ProTax2 dhe stafi tjetër i angazhuar në kuadër të projektit.

Gjatë vitit 2018, duke u bazuar në planin e projektit “Protax 2” dhe nevojave të Departamentit të Tatimit në Pronë, është bërë zhvillimi i moduleve dhe aktiviteteve si në vijim:

1. Digjitalizimi i plote procesit të anketimit të objekteve
2. Moduli i ri për regjistrimin e kontratave të shitblerjeve për të mundësuar regjistrimin e kontratave që përmbajnë me shume se një prone ose me shume se një blerës/shitës
3. Versioni i dytë i E-Office (zyra online e tatimit në prone) që mundëson menaxhimin e përmbajtjes nga ana e zyrtarëve përkatës të DPT-se
4. Inkuadrimi i hartave të Google (Google Maps) në të gjitha modulet e sistemit informativ Protax, për të lehtësuar anketimin në teren
5. Moduli i sistemit për vlerësim masiv të tokave dhe objekteve
6. Moduli i sistemit për tatim masiv të tokave dhe objekteve
7. Moduli i sistemit për faturim masiv të tokave dhe objekteve
8. Adaptimi i sistemit informativ Protax për të implementuar Ligji nr. 03/1-204 për Tatimin në Pronë të Paluajtshme si në vijim:
 - a. Ndryshimi i metodës së shpërndarjes së pagesës nëpër vitet tatimore
 - b. Shpërndarja proporcionale e pagesës për njësitë e ndryshme tatimore
 - c. Ndryshimi i afateve për ndëshkime dhe kamata
9. Inkorporimi i adresave zyrtare sipas Regjistrimit të Adresave të Agjencionit Kadastral të Kosovës
10. Pastrimi i regjistrimit të tatimpaguesve të regjistruar me shume se një here duke u bazuar në numrin personal dhe numrin e biznesit
11. Transferimi i përgjegjësisë për mirëmbajtjen dhe operimin e Infrastrukturës së Serverëve nga Ekipi i TI-së I projektit “Protax 2” në Divizionin e Infrastrukturës së Departamentit të Teknologjisë Informativ të Ministrisë së Financave
12. Mirëmbajtja e rregullt ditore e Regjistrimit të pronave dhe e softuerit të Sistemit Informativ Protax

Nga Ministri i Financave me 29.10.2018 është nënshkruar Udhëzimi Administrativ MF-Nr. 03/2018 për Metodologjinë e Vlerësimit.

Janë draftuar aktet nënligjore lidhur me:

- strukturën organizative të njësive për administrimin e tatimit në pronë në Komuna dhe parimet e administrimit tatimor;
- përgjegjësitë, procedurat e funksionimit dhe mënyrën e kompensimit të kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme;
- procedurat ankimore.

10. Departamenti Qendror Harmonizues (DQH)

Sa i përket **Zhvillimit dhe avancimit të kornizës ligjore dhe nënligjore për zhvillimin e Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Auditimit të Brendshëm**, vlenë të theksohet se Ligji i KBFP është dekretuar nga Presidenti i Kosovës dhe prej muajit maj 2018 ka hyrë në fuqi.

Pas hyrjes në fuqi NjQH ka filluar procedurat për nxjerrjen e udhëzimeve administrative.

Është formuar komisioni për hartimin e udhëzimit administrativ për përcaktimin e kritereve për themelimin e njësive të auditimit të brendshëm, komiteteve të auditimit dhe rregullores për menaxhimin financave dhe kontrollit. Udhëzimet administrative janë në fazën e finalizimit. Në bashkëpunim me USAID-in është përgatitur manuali për auditimin e prokurimit publik. Ky manual do të jetë pjesë e doracakut për auditim të brendshëm.

Në kuadër të **Ngritjes profesionale në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit**, është bërë pilotimi për Librin për përshkrimin e proceseve në nivelin komunal duke pilotuar në komunën e Vushtrrisë dhe Gjilanit, i cili dokument identifikon rreziqet për këto institucione në disa nga fushat e KBFP, si dhe ofron një analizë për menaxhimin e këtyre rreziqeve. Ky dokument për këto institucione do të përdoret si model për SSP-të e tjera;

Është bërë korniza model për monitorimin e KBFP me shembull praktike nga monitorimi i Ministrisë së financave, Komisionit për mijëra dhe minerale dhe Komuna e Vushtrrisë në bashkëpunim me ekspertët e SIGMA-s.

Kjo është arritur përmes trajnimeve të 198 zyrtarëve përgjegjës për menaxhimin e financave publike për zbatimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe aktivitete të tjera me theks të veçantë identifikimi analiza dhe menaxhimi i rrezikut.

Prej 110 SSP, të cilave u janë shpërndarë pyetësorët vetë-vlerësuese, 108 prej tyre ose 98% kanë plotësuar pyetësorët. Krahasuar me vitin 2016 kemi një rritje prej 2%

Në kuadër të **Programit për certifikimin e auditorëve të brendshëm** është organizuar trajnimi në programin për certifikim, në të cilin janë përfshirë 33 pjesëmarrës, prej tyre 27 jashtë sektorit publik. Me sukses programin e certifikimit gjatë vitit 2018 e kanë kryer 16 auditorë të brendshëm, të cilët janë pajisur me certifikata.

Lidhur me **Monitorimin dhe vlerësimin e Organizatave Buxhetore për zbatimin e Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe auditimit të brendshëm**, gjatë kësaj periudhe raportuese janë pranuar dhe analizuar 69 raporte nga NjAB mbi aktivitetet e zhvilluara në fushën për auditim të brendshëm për vitin 2017 dhe 63 raporte për periudhën e gjashtëmuajorit të parë të vitit 2018 si

dhe ka përfunduar monitorimi në dhjetë NjAB si: Ministrinë e Shëndetësisë, Administratën Tatimore të Kosovës, Komunën e Skenderajt, Komunën e Klinës, Komunën e Ferizajt, Komunën e Prishtinës, Komunën e Vitisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Komuna e Podujevës.

Është përgatitur Raporti Vjetor për Funkcionimi e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike për vitin 2017. Raporti është dërguar te Ministri i Financave e më pas në Qeveri, Kuvendin e Kosovës dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA). Raporti është aprovuar nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës.

11. Departamenti i Auditimit të Brendshëm (DAB)

Deri më 10 dhjetor të vitit 2018 janë kryer dhe monitoruar 14 auditime, 2 prej të cilave janë pilot auditime, monitorim në mbështetje të Programit Kombëtar për certifikimin e auditorëve të brendshëm në sektorin publik dhe 3 auditime janë në proces.

- Procedurat e menaxhimit të proceseve të Projekteve të Partneritetit Publiko Privat në DQPPP;
- Planifikimi dhe realizimi i të hyrave nga Tatimi ne Pronë në Komuna;
- Zyra Rregullative e Energjisë;
- Autoriteti i Aviacionit Civil;
- Agjencia Kundër Korrupsionit;
- Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore;
- Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i SHC;
- Ministria e Diasporës;
- Panelin për Ankesa dhe Parashtresa;
- Organi Shqyrtues i Prokurimit;
- Njësia Qendrore Harmonizuese e AB;
- Agjencia Qendrore e Prokurimit;
- Departamenti i Politikave Fiskale dhe Tregjeve financiare;
- Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme.

Ndërsa në proces të auditimit janë edhe 3 auditime:

- Divizioni i Prokurimit - MF;
- Divizioni për buxhet dhe financa- MF
- Departamenti i Buxhetit –MF

Të arriturat/veprimet:

Në 14 auditimet e përfunduara, janë dhënë 39 rekomandime të cilat janë pranuar në tërësi dhe adresuar për implementim.

Sfidat:

- Vlerësimi i funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në subjektet e audituara.

12. Departamenti Qendror i Partneritetit Publiko Private (DQPPP)

Në kuadër të **Ngritjes së kapaciteteve në fushën e Partneritetit Publiko-Privat për nivelin qendror dhe lokal**, janë mbajtur gjithsej 10 sesione 2 ditore trajnimi me zyrtarë publik në lidhje me PPP me gjithsej 60 pjesëmarrës. Plani i trajnimit për vitin 2019 për zyrtarë publik është dakorduar me IKAP.

Sa i përket aktivitetit për **Ndryshimin e Ligjit për PPP (Nr. 04/L-045) si dhe legjislacionit sekondar**, deri më tani, sipas procedurave për hartimin e draft-ligjit të ri për PPP janë ndërmarrë shumë veprime për ndryshim të këtij ligji, janë hulumtuar dhe shqyrtuar dispozita të reja si dhe janë elaboruar mundësitë dhe komentet e reja për t'u përfshirë në projekt-ligjin për PPP sipas përshtatshmërisë profesionale, ndërsa drafti-final është përfunduar. Tani kjo procedurë ndodhet në fazën finale, respektivisht do të vazhdohet me mbledhjen e fundit të anëtarëve të grupit punues dhe inkorporimin e komenteve të fundit nga ky grup, që më tutje procedura do të vazhdojë me dërgimin e dokumentacionit përkatës që ndërlidhet me propozimin, organeve relevante të cilat kanë 15 ditë pune për të komentuar lidhur me propozimin në pajtim me RRPQ.

Projekt-ligji për PPP në vete përmban: ligjin aktual, komentet nga konsultimi publik në fazën e koncept-dokumentit, komentet nga konsultimet e brendshme të zyrës sonë (DQPPP), 25 opsionet e dala nga Direktiva e BE-së 2014/23 dhe komente të tjera përkatëse të cilat janë realizuar gjatë takimeve konsultative me palët e interesit lidhur me ndryshimin e këtij ligji, si edhe është shqyrtuar nevoja për përditësimin e legjislacionit sekondar.

Është përgatitur nga DQPPP dhe janë aprovuar nga KPPP Termat e Referencës për NjMP për ANP:

Kjo njësi është themeluar me përbërje të re, sipas vendimit V. Nr. 04-18 të datës 17.05.2018.

Janë marrë gjithsej 5 vendime të KPPP-së:

- V. Nr. 01-18 më 16.04.2018 Shfuqizohet Vendimi i KPPP Nr. 04-2017 i dt. 17.05.2018;
- V. Nr. 02-18 më 16.04.2018 për Zbatimin e projekt-propozimit "Parkingu nëntokësor tek Fakulteti Filologjik";
- V. Nr. 03-18 më 22.02.2017 për vazhdimin e produktit nxitës për ANP "Adem Jashari";
- V. Nr. 04-18 më 17.05.2018 për Ndryshimin e Vendimit Nr. 16-01 i dt. 10.02.2016 me të cilin Ekipi për Monitorimin e Kontratës PPP-ANP ka përbërje të re;
- V. Nr. 05-18 më 04.06.2018 për Plotësimin e Vendimit nr. 05-2018.

13. Departamenti Ligjor (DL)

Brenda periudhës raportuese janë përcjell për aprovim në Qeverinë e Republikës së Kosovës 7 projektligje, të cilat janë aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Ministri i financave ka nënshkruar gjithsej 4 akte nënligjore.

Poashtu, ministri i financave ka nënshkruar 9 marrëveshje ndërkombëtare si dhe janë lëshuar një numër i madh i opinioneve për institucionet publike dhe palët private.

14. Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP)

DIEKP në Planin Vjetor të Punës së Ministrisë së Financave për vitin 2018 (PVPMF 2018) ka tre objektiva. Gjatë periudhës raportuese **2018** ka vazhduar me intensitet të lartë përbushja e tre objektivave nga plani i punës për vitin 2018, përmes realizimit të aktiviteteve të mëposhtme;

1. Koordinimi efikas i procesit të Integritimit Evropian, Planifikimit Strategjik dhe zhvillimit të politikave në Ministrinë e Financave

- DIEKP si Sekretariat i Grupit Koordinues (GK) të Menaxhimit të Financave Publike (MFP) ka bërë koordinimin e aktiviteteve në realizimin e qëllimit për Mbështetje Buxhetore Sektoriale (Sector Budget Support). DIEKP në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha strukturat e MF-së dhe institucioneve tjera të përfshira ka ndërmarr aktivitete që dalin nga zbatimi i Strategjisë për reformën e MFP-së (SRMFP) dhe plotësimit të kërkesave tjera që dalin nga ky proces. Gjatë kësaj periudhe janë dhënë kontribute në hartimin e indikatorëve Variabil të MFP-së për Mbështetjen Buxhetore Sektoriale, hapat për Rishikim të Planit të Veprimit të SRMFP dhe adresimi i nevojave për asistencën teknike të SBS. Në këtë kuadër, GK i MFP ka mbajtur gjithsej 21 takime pune, me mbështetjen e partnereve zhvillimor, 2 Video Konferenca me përfaqësuesit e Komisionit Evropian dhe dy takime zyrtare me përfaqësuesit e Komisionit Evropian, një në Prishtinë dhe një në Bruksel për periudhën raportuese. Gjatë muajit Dhjetor 2018 në mbledhje të Qeverisë është aprovuar rishikimi i Planit të Veprimit 2019-2020 dhe adresimi i rishikimit në SRMFP 2016-2020. Vlen të përmendet se prioritetet e strategjisë nuk kanë ndryshuar, por disa indikatorë janë larguar duke u zëvendësuar me tregues të Marrëveshjes Financiare.

- Gjatë periudhës raportuese Grupi Koordinues për MFP, i kryesuar nga MF ka mbajtur edhe takime tjera pune me tema të ndryshme. Po ashtu, është bërë dhe plotësimi i kërkesave të dala lidhur me Marrëveshjen e nënshkruar nga Komisioni Evropian dhe MIE për Mbështetjen Buxhetore Sektoriale (SBS) në fushën e MFP. Pas ratifikimit të Marrëveshjes më 13.11.2018, është hartuar dhe dërguar kërkesa për transferin e kështit të parë fiks në shumë prej 6 milion euro. Shuma e përgjithshme e Mbështetjes Buxhetore Sektoriale kap shumën prej 21 milion Euro si mbështetje buxhetore sektoriale dhe 4 milion Euro Asistencë Teknike.

- Janë organizuar dhe mbajtur dy takime të Dialogut për Menaxhimin e Financave Publike (MFP) më datë 25 Prill dhe 27 Nëntor 2018, ku në të parin është prezantuar Raporti Vjetor 2017

si dhe në takimin e dytë është diskutuar Plani i Veprimit për vitet 2019-2020. Komentet dhe kontributet e pranuar, si pjesë e konsultimeve publike, janë adresuar në Planin e Veprimit 2019-2020 për zbatimin e SRMFP 2016-2020.

- Në periudhën raportuese, DIEKP ka adresuar kërkesat e Ministrisë së Integritimit Evropian (MIE) lidhur me materialet/raportet të Ministrisë së Financave për Takimet e Nën-Komiteteve të Stabilizim Asociimit. DIEKP në koordinim me të gjitha strukturat e MF-së ka kontribuar në finalizimin e kontributeve nga strukturat e MF-së që janë të përfshirë në Nënkomitetet e Stabilizim Asociimit dhe ka marrë pjesë në takimet me Komisionin Evropian, si në Nënkomitetin e Stabilizim Asociimit për “Drejtësi, Liri dhe Siguri” dhe ka marrë pjesë në takimin me Komisionin Evropian më datë 6 dhe 7 Qershor në Prishtinë. Është bërë finalizimi i konkluzioneve pas çdo takimi të Nënkomiteteve nga fushëveprimi i MF si dhe monitorimi i zbatimit të Konkluzioneve të Nën-Komiteteve të Stabilizim Asociimit.

- DIEKP, ka bërë koordinimin e kontributeve me të gjitha strukturat e MF-së me qëllim adresimin e kërkesës që ka të bëjë me përditësimin e “Raportit për Vendin” nga Komisioni Evropian. është bërë koordinimi i kontributeve me të gjitha strukturat e MF-së me qëllim të adresimit të kërkesës për përditësimin e raportit për progresin bazuar në “Sfidat nga Raporti i KE-së për Kosovë 2018 dhe zbatimi i Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së”. DIEKP në bashkëpunim me gjitha strukturat e MF-së, ka ofruar kontributet për këtë raport.

- Gjatë muajit Prill, DIEKP ka ndërmarr aktivitete në mbështetjen dhe përgatitjen e materialeve për të gjitha strukturat e MF-së që janë të përfshira në kuadër të Komisioneve Ekzekutive (KE) të Agjendës Evropiane si KE “Ekonomia, Kontrolli Financiar dhe Statistikat”, "Tregtia, Industria, Dogana dhe Tatimet", “Tregu i Brendshëm, Konkurrenca dhe Mbrojtja e Konsumatorit” dhe “Tregtia, Industria, Dogana dhe Tatimet”.

- DIEKP ka marrë pjesë dhe ka dhënë mbështetje në Grupet Punuese si:

- GP për Koncept Dokumentin për hartimin e Koncept Dokumentit për Borxhin Publik. Ky Koncept Dokument është finalizuar dhe është aprovuar në mbledhje të Qeverisë.
- GP për Koncept Dokumentin për rishikimin e Legjislacionit Tatimor. Ky Koncept Dokument është finalizuar dhe është aprovuar në mbledhje të Qeverisë më datën 27 Prill.
- GP për Koncept Dokumentit për Lojërat e Fatit. Ky Koncept Dokument është finalizuar dhe është aprovuar në mbledhje të Qeverisë.
- GP për Ndryshimin e Rregullores për Ndihmë Shtetërore,
- GP për Hartimin e Koncept Dokumentit për politiken e Vullnetarizmit në Republikën e Kosovës.
- Koordinimin e GP III në Hartimin e Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me OSHC-të, Punëtorja më 14 Qershor 2018.
- Hartimin e draft Profilin të Migrimin 2017, kontribut në cilësinë e anëtarit të Autoritetit Qeveritar për Migrim, dhe
- Është mbështetur Sekretariati i Grupit të Përhershëm Qeveritar për Strategjinë e parandalimit dhe luftimit të ekonomisë joformale, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit 2014-2018. Sekretariati ka finalizuar edhe rishikimin e Planit të Veprimit për

vitin 2018 dhe ka finalizuar Raportin Vjetor për vitin 2017. Po ashtu ka filluar puna në hartimin e Strategjisë së re për vitet 2019-2023.

2. Koordinimi sa më i mirë i Asistencës së Jashtme në kuadër të MF-së

- Nën organizimin e DIEKP më 10 Prill 2018, u mbajt Takimi i Grupit Punues Nën Sektorial (GPNS) për koordinimin e asistencës së Donatorëve, ku pjesëmarrës në takim ishin anëtarët e Grupit Koordinues të SRMFP, Institucionet Qeveritare të Republikës së Kosovës, përfaqësues nga ZKM, Institucionet e pavarura që operojnë në Kosovë si dhe përfaqësuesit e komunitetit të Donatorëve të jashtëm.

- Janë plotësuar parakushtet për Përkrahjen Buxhetore Sektoriale (SBS) në fushën e Menaxhimit të Financave Publike. GKMFP ka arritur të negocioj tetë (8) indikatorë variabil për përfitimin e Mbështetjes Buxhetore Sektoriale në fushën e MFP. Marrëveshja financiare mbërrin shumën prej 21 milion Euro në formë të grantit si dhe përcillet me Asistencë Teknike në shumë prej 4 milion Euro.

- Gjatë muajit Qershor, bazuar në kërkesën e OECD-SIGMA janë organizuar takime individuale me gjitha strukturat përgjegjëse të përfshira në zbatimin e SRMFP për rishikimin e Planit të Veprimit si dhe takime individuale me partnerët kryesor zhvillimor të vendit. Misioni i tyre ishte tre ditor, për datat 18,19 dhe 20 Qershor 2018, ku DIEKP ka bërë koordinimin e aktiviteteve me akterët e përfshirë drejtpërdrejtë në zbatim të strategjisë për të adresuar të arriturat/sfidat në zbatim dakordimi i hapave të mëtejshëm. Në anën tjetër, takimet me partnerët zhvillimor kishin të bënin me koordinimin e Asistencës së Jashtme.

- Gjatë muajit Qershor, bazuar në kërkesën e Projektit PPF (Project Preparation Facility) janë organizuar takime individuale me gjitha strukturat përgjegjëse të përfshira në zbatimin e Prokurimit Publik, ku Projekti PPF (Project Preparation Facility) ka angazhuar një ekspert për;

- 1) zhvillimin e Termave të Referencës për Mbështetje suplementare për Prokurim Publik Efikas dhe Transparent në Kosovë, dhe
- 2) zhvillimin e Termave të Referencës për Mbështetje suplementare për Mbledhje të Qëndrueshme të të Hyrave të Brendshme.

- Gjatë tërë vitit është koordinuar mbështetja e Projektit të PPF të vendosur në MIE si dhe projektit OECD/SIGMA me ekspertizë dhe punëtori në fushën e MFP. Gjithashtu vlen të theksohet përkrahja e GIZ përmes Projektit rajonal për strukturat e IPA.

3. Zhvillimi, Monitorimi dhe Raportimi i zbatimit të Planeve të Punës dhe Planeve të Veprimit të Strategjive (si: PVPMF, PVPQ, PKZMSA, PRE, ERA, SRMFP, Profili i Migrimit, Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me OSHC etj.).

Janë grumbulluar dhe përpunuar kontributet lidhur me finalizimin e raporteve vjetore sipas kërkesave dhe afateve kohore si në vijim:

- **Agjenda e Reformave Evropiane (ERA).**- DIEKP ka ndërmarr aktivitete në mbështetjen dhe përgatitjen e materialeve për të gjitha strukturat e MF-së që janë të përfshira në kuadër të

Agjendës së Reformave Evropiane (ERA). Këto materiale janë përgatitur sipas kërkesave të pranuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MF-së, Kabineti, Ministria e Integritimit Evropian dhe OJQ-të. Dokumentet kanë përshkruar zbatimin e masave të parapara nga të gjitha strukturat e MF-së që janë të përfshira në kuadër të Agjendës së Reformave Evropiane (ERA). Janë përgatitur raportet dhe analizat si Raporti mbi zbatimin e aktiviteteve të ERA për periudhën Janar-Qershor, Janar - Dhjetor 2018 për KMIE, Raporti për zbatimin e ERA nga MF për portalin Lajmi Net etj. Vlen të theksohet se të gjitha veprimet e ERA, nga kompetenca e MF, janë përfunduar me kohë.

- **Programi Kombëtarë për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) 2018.**- Gjatë periudhës raportuese, DIEKP ka bërë koordinimin e aktiviteteve me të gjitha strukturat e MF-së dhe institucioneve tjera me qëllim të hartimit të raporteve tre mujore të Programit Kombëtarë për Zbatimin e MSA-së, për masat e parapara nga fushë veprimtaria e MF-së. DIEKP ka përgatitur të gjitha raportet tre-mujore për vitin 2018 mbi zbatimin e PKZMSA-së me kohë.
- **Plani Vjetor i Punës së Qeverisë (PVPQ) 2018.**- DIEKP ka bërë koordinimin e aktiviteteve me të gjitha strukturat e MF-së dhe ka përgatitur dhe finalizuar me kohë dhe cilësi të gjitha kontributet nga strukturat e MF-së që janë të përfshirë në Raportet tre mujore mbi zbatimin e Planit Vjetor të Punës së Qeverisë (PVPQ 2018).
- **Plani Vjetor i Punës të Ministrisë së Financave (PVPMF) 2018.**- Me kërkesë të ZKM-së, pas grumbullimit të kontributeve, në qershor kemi përgatitur MF draft raportin e të arriturave Shtator 2017- Qershor 2018. DIEKP, në bashkëpunim me të gjitha strukturat e MF-së ka bërë hartimin e raporteve të rregullta tremujore mbi Zbatimin e Planit Vjetor të Punës të Ministrisë së Financave PVPMF 2018, forma e raportimit në Narrativ dhe Tabelar.
- **Strategjia e Reformave të Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP) 2016-2020.**- Grupi Koordinues i (MFP) i mbështetur nga DIEKP si sekretariat, gjatë periudhës raportuese ka qenë i angazhuar në grumbullimin e kontributeve rreth Raportit Vjetor 2017 dhe Raportit 6 Mujor 2018 mbi zbatimin e SRMFP. Raportet janë finalizuar nga Sekretariati i Grupit Koordinues të MFP sipas planit në K2 dhe K4 2018. Raporti 2017 është prezantuar në takimin e KMRAP më datë 19 Prill 2018. Gjithashtu, në takimin e Dialogut për MFP të mbajtur me 25 Prill 2018 është diskutuar Raporti Vjetor 2017, ku konkluzionet e dala janë prezantuar në takimin e Grupit të Veçantë për RAP të mbajtur më 26 Prill 2018. Në raport janë adresuar edhe sugjerimet aktuale të SIGMA dhe rekomandimet e Komisionit Evropian nga të dhënat e Raportit Vjetor 2016. Raporti është publikuar në ueb faqen e MF në të tri gjuhët.
- **Liberalizimi i Vizave.**- Vlen të theksohet se në qershor 2018 kemi përgatitur kontributin e MF për Raportin përmbledhës për zbatimin e kritereve nga udhërrëfyesi për liberalizim të vizave.

15. Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të TI-së (DMSTI)

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2018 në DMSTI, janë kryer të gjitha aktivitetet që dalin nga objektivat e planit të veprimit sa i përket mirëmbajtjes dhe operimit të sistemeve, ofrimit të mbështetjes dhe ndihmës, përfundimi i implementimit të avancimit të infrastrukturës së TI-së (rrjetës dhe serverëve), lidhja e kontratës për projektin e Integritimit të Sistemeve dhe Datawarehouse si dhe është në proces të implementimit të këtij projekti me rendësi.

Ndër aktivitetet e departamentit gjatë kësaj periudhe janë:

Divizioni për Infrastrukturën e TI-së ka kryer aktivitetet si më poshtë:

- Menaxhimi i Qendrës së të Dhënave duke e respektuar Udhëzim Administrativ të Brendshëm MF-Nr. 01/2014 për Rregullat dhe Procedurat për Lejimin e Qasjes në Qendrën e të Dhënave të Ministrisë së Financave. Po ashtu është implementuar plotësisht plani i mirëmbajtjes së Qendrës së të Dhënave, me ç ‘rast janë kryer mirëmbajtjet mujore.
- Administrimi dhe mirëmbajtja e sistemeve dhe shërbimeve të TI-së (Infrastruktura e Serverëve dhe Storage, Infrastruktura Virtuale, vCenter, vSphere ESXi, Domain, Active Directory, DNS, DHCP, File dhe Print Server, Sophos Antivirus, Project Server, Sophos Web Appliance, Portali i Intranetit, BDMS, PIP, Protax System, Backups).
- Administrimi, mirëmbajtja dhe sigurimi i rrjetës dhe qasjes në Internet. Publikimi i e-shërbimeve në Internet. Mundësimi i qasjes së rrjetës së MF-ve nga institucionet tjera të Republikës së Kosovës duke përfshirë edhe komunat e Kosovës.
- Administrimi dhe mirëmbajtja e rrjetës pa tela
- Mirëmbajtja e qasjen në të gjitha sistemet të publikuara nga ASHI (Sistemi i vijueshmërisë, e-arkivën, e-pasuria, etj).
- Administrimi dhe mirëmbajtja e sistemit të IP telefonisë
- Përditësimi i infrastrukturës së rrjetës gjegjësisht përditësimi i pajisjeve switch dhe firewall.
- Përditësimi i infrastrukturës virtuale dhe migrimi i serverëve në infrastrukturën e re harduerike,
- Përditësimi i sistemeve operative dhe i disa aplikacioneve të Sistemit të Tatimit në Pronë
- Zhvendosjes e serverëve dhe storage të vjetër në data qendrën e MAP/ASHI
- Konfigurimi i pajisjeve të vjetra për rimëkëmbjen në rast të fatkeqësisë

Divizioni i Operimeve të TI-së ka kryer aktivitetet si më poshtë:

- Instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e kompjuterëve, laptopëve dhe printerëve (Formatizimi, instalimi i aplikacioneve, përditësimi i sistemeve operative dhe aplikacioneve, përgatitja për ti futur në domain, futja në domain).
- Trajnimi i zyrtarëve komunal në përdorimin e sistemit të Tatimit në Pronë
- Regjistrimi i pagesave në sistemin e Tatimit në Pronë
- Bërja Backup dhe ruajtja e shënimeve të sistemit të Tatimit në Pronë në lokacionet të sigurta.

Aktivitetet e divizionit të Aplikacioneve të TI-së:

Janë kryer të gjitha aktivitetet që ndërlidhen me funksionimin e sistemeve softuerike të MF si: PIP; BDMS; Sistemi i Tatimit në Pronë. Është bërë kopja rezervë ditore dhe periodike e të gjitha sistemeve.

Është bërë analiza e nevojave për projektin e Integritit të Sistemeve dhe Data Warehouse

Projektet në vazhdimësi:

- Vazhdon implementimi i projektit të Integritit të sistemeve dhe datawarehouse
- Vazhdon implementimi i ndryshimeve të Sistemin e Tatimit në Pronë- Protax e-Office
- Konfigurimi i sistemeve për të ofruar shërbimin Protax e-Office
- Planifikimi dhe implementimi i sistemit për CHU.

16. Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme (DSHP)

Në përgjithësi janë realizuar objektivat dhe veprimet e parapara me planin vjetor të punës. Veprimet në vijim janë të paraqitura sipas objektivave.

I. Divizioni i Burimeve Njerëzore:

- Ndryshimi dhe azhurnimi mujor i listave të pagave;
- Menaxhimi në vazhdimësi i informatave për burimet njerëzore;
- Krijimi dhe azhurnimi i dosjeve të personelit;
- Përgatitja dhe lëshimi i 181 (njëqind e tetëdhjetë e një) akteve administrative, lidhur me burimet njerëzore;
- Janë zhvilluar gjashtë procese për angazhime sipas Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta, dhe kanë rezultuar me 9 zyrtar të angazhuar;
- Përgatitja dhe dërgimi për publikim i konkurseve të brendshme (avancim), të jashtëm dhe rishpallje, si dhe menaxhimi i këtyre proceseve të rekrutimit (janë shpallur tetë konkurse të brendshme – avancime, si dhe trembëdhjetë konkurse të jashtëm- publike, dhe një rishpallje. Gjatë kësaj periudhe, kemi 13 punësime të reja dhe 9 avancime. Ka pasur 6 lëvizje të stafit brenda ministrisë, një transferim nga jashtë në ministri, dhe një transferim në institucion tjetër nga ministria. Të gjitha kërkesat për autorizim të konkurseve (të brendshme dhe publike) janë realizuar përmes sistemit dhe procedurës së SIMBNJ-së;
- Gjatë kësaj periudhe, 8 zyrtar kanë ndërprerë marrëdhënien e punës, dy prej tyre janë pensionuar;
- Përbushja e të gjitha obligimeve për Komisionet Përzgjedhëse, Komisionin Disiplinor, dhe Komisionin e Ankesave;
- Administrimi i Sistemit për Menaxhimin e Vjueshmërisë në Punë;
- Administrimi i vlerësimit të nevojave për trajnimi, monitorimi dhe raportimi (kryesisht trajnimet e stafit janë realizuar në IKAP, CEF të Sllovenisë, dhe në JIV), e që rezulton me mbi 70 zyrtarë pjesëmarrës në trajnime të ndryshme;

Sfida: Mos funksionalizimi i plotë i Sistemit Informacionit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Drejtat e njeriut

Në vazhdimësi është promovuar dhe monitoruar respektimi i legjislacionit në fushën e të drejtave të njeriut dhe komuniteteve në ministri, si dhe janë përbushur të gjitha obligimet që kanë dalë nga legjislacioni përkatës, praktikat e mira ndërkombëtare dhe politikat në fuqi. Në plotëni është zbatuar barazia gjinore dhe të drejtat e komuniteteve. Përfaqësimi, bashkëpunim dhe kontributi i zyrtarëve në grupet punuese, punëtoritë dhe pjesëmarrjet e ndryshme të fushës përkatëse, ka qenë i mirë, duke treguar performancë të lartë. Ministria e Financave nuk ka pasur asnjë rekomandim nga Komisioneri për gjuhët, dhe as nga institucioni i Avokatit të Popullit.

II. Shërbimet logjistike, janë realizuar në bazë të Planit të punës, kryesisht përmes këtyre aktiviteteve:

- Krijimi i kushteve të punës për stafin e MF, në objektet e vendosura, si në ndërtesën e Qeverisë dhe objektet e marrë me qira, brenda mundësive përfshirë edhe mirëmbajtjen si dhe sigurimi

i tyre, Gjatë vitit është marrë me qira edhe një objekt privat me 510 metra katrorë, në të cilën ndërtesë janë vendosur dy Departamente;

- Administrimi i veturave ka qenë në pajtim me legjislacionin në fuqi. Gjatë gjithë vitit janë ofruar shërbime efikase dhe efektive sipas kërkesave të zyrtarëve, dhe me kohë. Mirëmbajtja dhe servisimet kanë qenë të rregullta. Gjatë vitit për ofrimin e shërbimeve të transportit, MF ka marrë me qira, sipas Kontratës të AQP, gjashtë automjete, derisa është liruar nga 12 automjete zyrtare të cilat ia ka dorëzuar MAP për shitje (sipas vendimit të qeverisë);
- Ofrimi i shërbimeve të përkthimit në gjuhën angleze 3,255 faqe dhe 198 orë përkthim simultan, derisa në gjuhën serbe janë përkthyer 5,166 faqe, përkthim simultan 56 orë, ndërsa janë lekturuar 625 faqe. Përkthimet dhe shërbimet përmes Operatorit ekonomik janë realizuar sipas kërkesave dhe në pajtim me Kontratën;
- Njësia për administrimin e dokumenteve është përkujdesur për realizimin e punëve në zyre në pajtim me legjislacionin. Përmes NjAD janë pranuar gjithsejtë 3,393 shkresa dhe dokumente zyrtare, ndërsa janë realizuar gjithsejtë 3,454 shkresa dalëse dhe dokumente tjera zyrtare. Pranimi dhe shpërndarja e dokumenteve zyrtare është bërë brenda afateve ligjore, dhe i gjithë materiali që ka qarkulluar është evidentuar edhe në formën elektronike;
- Gjatë kësaj periudhe janë protokolluar gjithsejtë 1,130 fatura.

Sfida

Është për shqetësim që gjatë gjithë vitit, përkundër përpjekjeve, kërkesave dhe vërejtjeve tona nuk kemi marrë shërbimet e nevojshme të ofruara nga operatori ekonomik që ka përzgjedhur MAP, si në pastërti edhe në mirëmbajtje si intervenimi në klimatizimi, riparim të dritareve, perdeve dhe shërbime tjera sipas kërkesave!

Aktivitet tjera nga Zyra e Drejtorit

- Aktivitetet për drejtimin e Departamentit, lidhur me realizimin e objektivave të Departamentit dhe menaxhim;
- Kontributi dhe pjesëmarrja në Grupin Punues për pakon e ligjeve për Reformën e Administratës Publike (Projektligji për Paga, PL për Organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, dhe PL për Zyrtarët Publik), si dhe kontributi në Grupin Punues – Sekretariatit për Racionalizimin e Agjencive (Plani i Veprimit);
- Pjesëmarrja dhe kontributi në Komisioni e Përbashkët për Shtesa (MAP-MF);
- Kontributi në Komisione- grupe punuese, si: Koncept dokumentin për inspektime (MTI), Grupi Punues për Rezervat shtetërore, Analizën e Njesisë së përkthimeve, dhe Koncept dokumenti për përkthime (ZKM);
- Angazhimet në grupet e brendshme të MF, e në veçanti Rishikimi i Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike;
- Administrimi i punës praktike me studentët nga UP “Hasan Prishtina” dhe Kolegjet Private, gjithsej 78 studentë kanë përfunduar punën praktike në MF dhe agjencitë vartëse të saj, në periudhën gusht-tetor 2018;
- UD i udhëheqësit të Divizionit për Raportim Financiar;
- Puna në nëntë Komisione Përzgjedhëse, brenda MF;

17. Departamenti për Ndihmën Shtetërore (DNSH)

DNSH-ja në fillim të muajit prill ka përfunduar procesin e rekrutimit me 5 zyrtarë të lartë për DNSH, prej tyre dy zyrtarë të lartë në Divizionin për Mbikëqyrjen e Kontrollit të Ndihmës Shtetërore dhe tre (3) zyrtarë të lartë për Divizionin e Vlerësimit të Ndihmës Shtetërore. Tani departamenti numëron gjithsej shtatë (7) zyrtarë.

Sa i përket kornizës Ligjore, në bashkëpunim me ekspertët e TAIX-it është hartuar Rregullorja për Procedurat e Njoftimit në bazë të Ligjit të ri për Ndihmën Shtetërore dhe Draft Rregullorja për Punën e Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

Rregullorja për Procedurat e Njoftimit është miratuar, ndërsa Rregullorja për Punën e Komisionit të Ndihmës Shtetërore pritet të miratohet posa të emërohet Komisioni për Ndihmën Shtetërore. Sa i përket legjislacionit dytësorë, është bërë përafrimi me direktivat e BE-së.

Sa i përket trajnimeve, stafi i DNSH-së deri më tani ka përfituar nga dy projekte:

1. Projekti i Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar -një ekspert ka filluar të trajnoj stafin e DNSH-së dhe dhënësit potencial të ndihmës shtetërore lidhur me krijimin e një inventari për ndihma shtetërore dhe
 2. Projekti i BE-së - një ekspert në përkrahje të DNSH-së për krijimin e kornizës ligjore.
- Të dy këto projekte do të vazhdojnë deri në Prill 2019.

Nga Projekti i Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, gjatë muajit dhjetor, DNSH ka filluar organizimet e tryezave informuese për institucionet dhënëse;

1. Ministritë
2. Agjencionet
3. Rregullatorët
4. Komunat

Zyrat dhe institucionet tjera që janë identifikuar si dhënës të ndihmës shtetërore.

Gjithashtu DNSH ka filluar procesin e informimit lidhur me zbatimin e rregullave të ndihmës shtetërore.

Eksperti i TAIX-it ka mbajtur trajnim me stafin e DNSH-së gjatë muajit qershor, ku është shqyrtuar rregullorja për punën e komisionit të ndihmës shtetërore.

DNSH ka bashkëpunim me të gjitha institucionet ndërkombëtare si:

- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Vjenë,
- Zyrën Ndërlidhëse të Bashkimit Evropian në Prishtinë,
- Drejtorinë Gjenerale të Konkurrencës përkatësisht sektorin e Ndihmës Shtetërore në Bruksel,
- Departamentin e Ndihmës Shtetërore në Maqedoni,
- Sektorin e Ndihmës Shtetërore në Shqipëri,
- Ambasadat në vend dhe institucionet e tjera që kanë lidhshmëri me ndihmën shtetërore.

18. Divizioni për Komunikim me Publikun (DKP)

Nga Zyra për Komunikim me Publikun gjatë vitit 2018 janë hartuar dhe publikuar 106 Komunikata për Media.

Janë organizuar dhe mbajtur 26 takime, ku prej tyre disa takime me media për nënshkrime të marrëveshjeve të ndryshme, takime me bizneset, konferenca për Raportin Gjashtëmuor për të hyrat dhe shpenzimet si dhe eventit për lansimin e Portalit të Transparencës.

Janë organizuar intervista për ministrin Bedri Hamza në televizionet dhe mediat tjera vizuale si në: RTK, KTV, KLAN KOSOVA, TV21, Radio Evropa e Lirë, TV Dukagjini, Kosova Press, T7, Telegrafi, Infokusi.

Gjithashtu janë organizuar intervista edhe për zëvendësinistrin Fatmir Gashi dhe për këshilltarin Lulzim Rafuna, drejtorin e DTP Shkelzen Morina si dhe drejtorin PPP Ilir Rama.

ZKP-ja gjatë këtij viti ka pranuar 526 pyetje, ku prej tyre për 507 kemi kthyer përgjigje dhe 19 prej tyre i kemi orientuar në institucionet tjera përgjegjëse për të marrë përgjigje. Përgjigje janë kthyer për gazetarët nga gazetatat ditore si: Koha Ditore, Kosova Sot, Zëri, Bota Sot, Epoka e Re, portalet Ora Info, Epoka e Re, Kosova Press, Ekonomia Online, Tribuna Chanel, Zëri, Telegrafi, Ndërtimi Info, Arbresh.TV, Gazeta Express, Infokusi, Lajmi.net etj.

Gjithashtu, ZKP-ja ka pranuar Kërkesa për qasje në dokumente publike, ku të gjithë parashtruesve për të pasur qasje në dokumente publike ju është lejuar qasja dhe palëve ju është kthyer përgjigje brenda afatit të përcaktuar me ligj.

Në ueb faqen e Ministrisë janë publikuar të gjitha materialet të cilat janë dërguar nga departamentet përkatëse të Ministrisë së Financave. Materialet janë publikuar në të tri gjuhët zyrtare.

Gjatë vitit 2018, ZKP-ja ka pranuar kërkesa për të lekturuar dokumente zyrtare, raporte, komunikata etj., në numër prej 625 faqesh të cilat janë lekturuar dhe korrigjuar në afatin e caktuar kohore.

Kemi pasur kërkesa nga 16 studentë për t'iu ofruar mbështetje me materiale për punimet e diplomës, ku edhe iu kemi ofruar ndihmë me materiale dhe këshilla shtesë.

Nga ZKP është bërë edhe fotografimi i të gjitha aktiviteteve të Ministrisë së Financave.

Po ashtu është dizajnuar edhe Raporti për IKP E REFOND i ATK-së.

Po ashtu është bërë edhe ridizajnimi i ueb faqes së MF-së.

ZKP ka bërë Lansimin publik të Portalit të Transparencës me datë 4 dhjetor të po këtij viti, e arritur kjo e vlerësuar lartë si nga ministri Bedri Hamza, gjithashtu edhe nga ambasadori gjerman në Kosovë Christian Heldt dhe përfaqësuesit e GIZ-it.

19. Divizioni i Prokurimit (DP)

Gjatë periudhës raportuese vjetore, sipas kërkesave dhe aprovimeve të ZKA janë zhvilluar 54 (pesëdhjetë e katër) aktivitete të prokurimit për furnizime, shërbime dhe riparime sipas kërkesave të Departamenteve të MF, Thesarit, NJIF-it dhe AQP-së.

Nga 54 (pesëdhjete e katër) aktivitetete të zhvilluara, janë nënshkruar 47 kontrata, 1 aktivitet është anuluar dhe 6 janë në proces të tenderimit dhe vlerësimit.

Nga kontratat e nënshkruara, 31 janë përmbushur dhe 16 janë në përmbushje si kontrata afatgjate. Janë paraqitur nëntë kërkesa për Rishqyrtim nga OE lidhur me aktivitetet e Prokurimit në MF. Në nëntë raste kërkesat janë refuzuar nga Divizioni i Prokurimit si të pa bazuara dhe tetë nga to nuk janë kontestuar më pas në OSHP. Një nga OE më pas ka parashtruar Ankesë në OSHP dhe me Vendim, OSHP-ja e ka refuzuar Ankesën e OE si të pa bazuar.

Janë punuar 359 Urdhër blerje në Modulin e blerjes në SIMFK përmes të cilave janë kryer obligimet e pagesave ndaj kontraktuesve të MF.

20. Divizioni për Raportim Financiar (DRF)

DRF, rolin e vet mbështetës dhe profesional, për Komisionin Kosovar për Raportim Financiar e ka përmbushur brenda kapaciteteve dhe në pajtim me legjislacionin.

Në mars të këtij vit është aprovuar ligji ri për kontabilitet, raportim dhe auditim, i cili fillon të zbatohet në fillim të vitit 2019, derisa viti 2018 ka qenë vit kur janë paraparë aprovimi i akteve nënligjore për zbatim.

Në muajin qershor 2018, është bërë ri-emërimi i anëtarëve të KKRF, i cili pas funksionalizimit, së bashku me Divizionin e Raportimit Financiar, kanë intensifikuar aktivitetet në përgatitjen e akteve nënligjore si dhe rregulloren e punës në pajtim me ligjin e ri, por edhe realizimin e detyrave tjera sipas ligjit.

KKRF ka hartuar dhe miratuar draft Udhëzimin administrativ për strukturën dhe përmbajtjen e raportimeve financiare vjetore, i cili ndodhet në procedurë të mëtejshme ligjore në departamentin ligjor të MF.

Është hartuar dhe miratuar rregullorja e punës së KKRF-së. Aktet tjera administrative, të parapara me ligjin e ri, janë në fazën e fundit të finalizimit dhe priten të kalojnë të gjitha procedurat dhe të aprovohen deri në fund të vitit.

KKRF ka pranuar 360 pasqyra financiare, prej tyre 15 të konsoliduara të audituara nga subjektet ekonomike, të cilat janë të obliguar t'i dorëzojnë. Nga këto pasqyra të dorëzuara është hartuar Raporti vjetor i pasqyrave financiare dhe është publikuar në web faqen e Ministrisë së Financave. KKRF gjatë këtij viti ka aprovuar këto rekomandime të komisionit për licencim: 35 (tridhjetë e pesë) auditorë ligjorë vendore vazhdim licence, 13 auditorë ligjorë të huaj vazhdim licence, 13 firma vendore ligjore vazhdim, 8 firma të huaja ligjore vazhdim licence.

Sfidë për KKRF- në mbetet financimi i Bordit për Mbikqyrje Publike i cili do të themelohet sipas Ligjit të ri për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim i cili do të hyj në fuqi prej 1 janarit 2019, si dhe paisja me një softwer për regjistrimin elektronik të pasqyrave financiare të audituara dhe të dorëzuara në KKRF. Gjithashtu edhe zgjidhja e Udhëheqësit të Divizionit dhe mos mundësia e zëvendësimit të një zyrtarje (pushim i lehonisë) janë vlerësuar sfida dhe pengesa në realizim e plotë të objektivave!

21. Divizioni për Buxhet dhe Financa (DBF)

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2018, DBF ka proceduar me përgatitjen e planit të rrjedhës së parasë së gatshme për vitin fiskal 2018, duke u mbështetur në Rregulloren nr.03/2014 për Alokimin e Fondeve, si dhe kemi plotësuar formularët e autorizimeve për fillimin e vitit fiskal 2018.

DBF, më 14.01.2017 ka pranuar një shkresë nga NJQH. Administrata e Qendres së Ministrisë së Financave ka përgatitur pyetësin e vetë-vlerësimit për menaxhimin financiar dhe kontrollit, për cilësinë e sistemit të menaxhimit financiar dhe sistemit të kontrollit financiar për vitin e raportimit Janar - Dhjetor 2016.

Listat kontrolluese për Vetë-vlerësim sipas Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit MFK, Administrata e Qendrës së Ministrisë së Financave ka përgatitur formularët në PDF sipas kërkesës së NJQH.

Gjatë periudhës raportuese është bërë procedimi i të gjitha pagesave sipas Rregullave Financiare të cilat janë në fuqi si dhe hapjen dhe mbylljen e Avanceve të udhëtimeve zyrtare.

Kostimet e bëra nga Divizioni për Buxhet dhe Financa për UA, Rregullore dhe projekt Ligjeve të cilat janë proceduar për kostim nga Departamenti Ligjor prej periudhes 01.01.2018- 12.12.2018:

1. Udhëzim Administrativ për zbatimin e procedurave Qendrore të Prokurimit Publik,
2. Marrëveshja për huanë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankes Evropiane për Investime për Projektin Prishtinë - Pejë,
3. Segmenti Kievë Zahaq, Ratifikimi i marrëveshjes për kredi në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe BERZH-it,
4. Koncept Dokumenti për ndryshimin e Politikave Fiskale dhe Bujqësore për prodhimin e duhanit dhe cigareve në Kosovë,
5. Marrëveshja për Kredi midis Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG,
6. Projekt Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Financim midis Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, për Projektin e Ekonomisë digjitale të Kosovës,
7. Projektligj për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës lidhur me Programin e mbështetjes për ujësjellës dhe kanalizim në zonat rurale- FAZA,
8. Projektligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar,
9. Projekt Ligji për Tatimin në të Ardhurat Personale,
10. Projekt Ligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave,
11. Procedura dhe Forma e Njoftimit për Ndihmën Shtetërore,
12. Projekt Udhëzim Administrativ për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit,
13. Koncept dokumenti për Lojërat e Fatit,
14. Marrëveshja për Kredi midis Republikës së Kosovës dhe RAIFFEISEN BANK INTERNATIONAL AG,
15. Marrëveshja për Kredi midis Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG,
16. Marrëveshja për Kredi midis Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG,
17. Marrëveshja për Kredi midis Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG,
18. Projekt Rregullore për Themelimin dhe zbatimin e funksionit të ABSSP,
19. Rregullore për Përdorim të Kartelës Kreditore për udhëtime zyrtare dhe
20. Projekt Udhëzimi Administrativ për Metodologjinë e Vlerësimit.

Ministria e Financave ka bërë barazimin e të hyrave dhe të shpenzimeve me Thesarin si dhe është bërë korrigjimi i vlerës së pasurisë qeveritare në menaxhim të Organizatës Buxhetore.

Ministria e Financave ka përgatitur pasqyrat financiare për vitin fiskal 2017, në harmoni me standardet e kontabilitetit për Institucionet publike, të përgatitura sipas Rregullës Financiare nr. 06/2011.

Duke u mbështetur në Ligjin nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, neni 17, pika 2 dhe 3, Ministria e Financave ka përgatitur raportin e progresit financiar dhe fizik për të gjitha projektet kapitale.